

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

NDODHIA E MUBAHELESË NË ISLAM

Tiranë, 2023

Ndodhia e Mubahesë në Islam

Titulli: *Ndodhia e Mubahesë në Islam*

Përgatiti: **Haxhi Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: Shoqata Flladi – Tiranë, 2023

FJALA E BOTUESIT

Në Kur'anin famëlartë, në ajetin 61 të sures "Âl Imran", thuhet:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا وَأَبْنَاءَكُمْ وَ
نِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

"Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: 'Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj të lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!'"

Një prej ndodhive historike në Islam është ndodhia e Mubahesë. Kuptimi i fjalës “mubahaleh” është “el muala’aneh”, “mallkim, ose lutje për mallkim”.

Kjo mënyrë e mallkimit, ndoshta nuk njihej më parë nga arabët. Por ajo ka qenë një prej metodave të vërtetësisë së Profetit Muhamed dhe besimit të tij të palëkundur. Gjithashtu, kjo ndodhi nxjerr në pah pozitën e lartë të Ehli Bejtit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe përparësinë e tyre në çdo kohë.

Si do të ishte e mundur, që një njeri, që nuk besonte plotësisht në lidhjen e tij me

Allahun, të hynte në mejdanin e mallkimit? Si do t' u kërkonte kundërshtarëve të tij, që të bashkoheshin me të dhe t' i luteshin Allahut, që t' u zbresë mallkimin e Tij mbi gënjeshtarin e më pas, të shihte menjëherë se çfarë do t' i ndodhte gënjeshtarit?

S'ka dyshim se hyrja në mejdanin e mallkimit është shumë e rrezikshme, sepse, nëse kërkuesi i zbritjes së mallkimit nuk sheh përgjigje të lutjes dhe as ndikimin e ndëshkimit të Allahut ndaj kundërshtarëve, atëherë përfundimi i saj do të ishte katastrofë për kërkuesin.

Vallë, një njeri i logjikshëm dhe arsyetues, a mund ta marrë këtë nismë, pa qenë i bindur se rezultati do të ishte në anë

të tij? Thuhet se ftesa e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të mallkuar, konsiderohet një prej argumenteve të vërtetësisë së profecisë dhe besimit të prerë të tij, pa llogaritur rezultatet që do të sillte ajo.

Në transmetimet islame, për këtë çështje, lexojmë këtë ngjarje: Kur u propozua bërja e mallkimit (mubahesë), përfaqësuesit e të krishterëve të Nexhranit i kërkuan Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) afat kohor, që të konsultoheshin me të mëdhenjtë e tyre. Kërkesa e tyre u pranua. Rezultati i konsultimit të tyre, bazuar në anën psikike, ishte se ata i urdhëruan

njerëzit e tyre që të mallkojnë, pa u frikësuar, nëse shohin se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sjellë shumë njerëz, sepse ky veprim ka si qëllim futjen e frikës e të tmerrit në zemrat e njerëzve dhe do të çonte në çoroditje e zhurmë.

Kjo mënyrë nuk do të jetë e vërtetë. Nëse shohin se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka sjellë disa persona dhe të vegjël prej familjes së tij, për të mallkuar, do ta kuptojnë se ai është profet i Allahut dhe nuk do duan të mallkohen. Të krishterët erdhën në vendin e caktuar. Pastaj panë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po vinte.

Në krah kishte Hysenin dhe në dorën e djathtë mbante Hasanin. Pas tij ishin Aliu dhe Fatimja. Kur të krishterët panë këtë skenë, i mbuloi frika dhe refuzuan që të mallkohen. Ata pranuan që të bashkëpunonin me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me kushtet e Ehlu Dhimmeh (pakica jomyslimane që jeton në mesin e myslimanëve sipas kriterëve dhe kushteve të caktuara).

Mubahete është një prej treguesve të madhështisë së Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Komentuesit e Ehli Sunetit dhe shi'itët thonë se ajeti i mallkimit ka zbritur

për Ehli Bejtin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Personat që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori për të kryer ritualin e mallkimit, ishin: Hasani, Hyseni, Aliu dhe Fatimja.

Kuptimi i togfjalëshit “ebnaena”- “fëmijët tanë”, i përmendur në ajet, nënkupton Hasanin dhe Hysenin (*Paqja qoftë mbi ta!*); kuptimi i togfjalëshit “nisauna”-“gratë tona” nënkupton vetëm Fatimen dhe kuptimi i frazës “enfusena” nënkupton Aliun. Ka shumë hadithe që flasin për këtë përkatësi.¹

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 10, f. 141 dhe 350.

Disa dijetarë të Ehli Sunetit janë përpjekur të mohojnë praninë e haditheve për këtë çështje. Autori i komentimit “El Manar” rreth komentimit të këtij ajeti, thotë: “Transmetimet e përbashkëta thonë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) zgjodhi për të kryer ritualin e mallkimit, Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysenin, duke i dhënë kuptimin fjalës “nisaena”- për Fatimen dhe “enfusena”- për Aliun. Këto burime janë të shi’itëve dhe qëllimi i tyre është i qartë në këtë çështje. Ata u përpoqën ta përhapin këtë, duke përfshirë edhe shumë prej Ehli Sunetit”.

Që të sqarohet më shumë kjo e vërtetë, po përmendim disa hadithe nga

burimet e Ehli Sunetit: Kadi Nurullah Esh Shushteri, në librin e tij “Ihkakul Hak” (vëllimi 3, faqe 46, Botim i ri), përmend mendimin e përbashkët të komentuesve, se togfjalëshi “ebnaena” tregon Hasanin dhe Hysenin; togfjalëshi “nisaena” tregon Fatimen dhe “enfusena” tregon Aliun. Në shënimet në fund të faqes përmend gjashtëdhjetë dijetarë të mëdhenj të Ehli Sunetit, të cilët thonë se ajeti i mallkimit ka zbritur për Ehli Bejtin. Emrat e këtyre dijetarëve i përmend në faqet 46 – 76 të po këtij libri.

Dijetarët e njohur, prej të cilëve është përcjellë kjo thënie e qartë, janë:

1- Ahmed ibn Hahbeli, “El Musned”, vëll. 1, f. 185, Botim i Egjiptit.

2- Muslim ibn el Haxhxhaxh el Nijshaburij, autori i një prej gjashtë sahihëve të njohur të Ehli Sunetit, vëll. 7, f. 120, Botim i Muhamed Ali Sabijh, Egjipt.

3- Et Tabari, në komentimin e tij të njohur “Xhamiul Bejan”, vëll. 3, f. 192,

Botim i shtypshkronjës “El Jemnijeh”,
Egjipt.

4- El Hakimi, “El Mustedrek”, vëll. 3,
f. 150, Botimi i Hajdar Abad-ed Dekn.

5- El Hafidh ebu Naim el Asfahanij,
“Delailu Nubuveh”, f. 297, Botimi i Hajdar
Abad- ed Dekn.

6- El Uahidij en Nishaburij, “Esbabu
Nuzul”, f. 74, Botim i shtypshkronjës “El
Hindejeh”, Egjipt.

7- Fahu Raziu, në komentimin e tij të njohur “Tefsirul Kebijr”, vëll. 8, f. 85, Botim i shtypshkronjës “El Behijeh”, Egjipt.

8- Ibn el Ethijr, “Xhamiul Usul”, vëll. 9, f. 470, Botim i shtypshkronjës “Es Sunetul Muhamedijeh”, Egjipt.

9- Ibn el Xhevzij, “Tedhkiretul Khavas”, f. 17, Botim i Nexhefit.

10- El Kadij el Bejdauj, në komentimin e tij, vëll. 2, f. 167, shtypshkronja “El Munijreh”, Egjipt.

11- El Alusij, “Ruhul Meanij”, vëll. 3, f. 193, shtypshkronja “El munirijeh”, Egjipt.

12- Et Tantauj, “El Xheuhir”, vëll. 2, f. 120, shtypshkronja “Mustafa el Babij el halebij”, Egjipt.

13- Zamakhsharij, “El Keshaf”, vëll. 1, f. 193, shtypshkronja “Mustafa Muhamed”.

14- El Hafidh Ahmed ibn Haxher el Askalanij, “El isabetu”, vëll. 2, f. 503, shtypshkronja “Mustafa Muhamed”.

15- Ibn Sabag, “El Fusulul Muhimeh”, f. 108, shtypshkronja “Nexhef”.

16- Eruditi Kurtubi, “El Xhamiul Ahkamul Kur’an”, vëll. 3, f. 104, shtypshkronja e Egjiptit, viti 1936.

Nga Sahihu i Muslimit, është transmetuar në librin “Gajetul Muram”, në kreun “Virtytet e Ali ibn ebu Talibit”, se një ditë Muavija i tha Sa’d ibn ebi Uekkasit: “Përse nuk e shan Ebu Turabin (Imam Aliun)?!”

Sa’di iu përgjigj: “Unë e kam lënë sharjen e tij, që kur kujtova tri gjëra, që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë për Aliun. Njëra prej tyre është kur ka zbritur ajeti i mubahesës. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk mori tjetër në këtë ndodhi, vetëm Aliun, Fatimen,

Hasanin dhe Hysenin dhe tha: “O Zot, këta janë familja ime!”²

Autori i komentimit “El Keshshaf”, i cili është prej dijetarëve të njohur të Ehli Sunetit, ka mendimin se ky ajet është argumenti më i fortë për përparësinë e Ehlit të Kisaut (mantelit), Ehli Bejti.

Komentuesit, transmetuesit dhe historianët shi’itë, gjithashtu, janë të një mendimi se ajeti i mallkimit (mubahelesë) ka zbritur për Ehli Bejtin. Autori i komentimit “Nuru Thakalejn” ka

² Sahihu i Muslimit, vëll. 7, f. 120. “El Gadir”, vëll. 3, f. 200.

përmendur shumë hadithe për këtë çështje.³

Gjithashtu, edhe në librin “A’jun Akhbaru Rida” përmendet tubimi shkencor që organizoi Me’ muni në pallatin e tij. Në atë tubim, Imam Rizai ka thënë: “Allahu i ka dalluar të pastrit nga krijesat e Tij. Në ajetin e ballafaqimit e urdhëroi të Dërguarin e Tij që të lutet, duke i mallkuar ata. Allahu i Madhëruar thotë: **“A tyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait...”** Atëherë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) doli me Aliun, Hasanin, Hysenin dhe Fatimen (*Paqja qoftë mbi ta!*). Askush nuk e ka

³ Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 348-350.

pasur këtë veçori para tyre. Ata janë më të përkryerit dhe më të ndershmit e njerëzve”.⁴

Në këtë libërth kemi sjellë komentimin e ajetit 63 të sures “Al Imran”, i cili quhet ndryshe Ajeti i lutjes për mallkim (Ajetul Mubahelah), sipas komentimeve të mëposhtme:

1- El Tabari, “Xhamiu El Bejan fi Tefsiril Kur'an”. Ebu Xhafer Muhamed ibn Xherijr ibn Jezijd ibn Kethijr ibn Galib El

⁴ Tefsiri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 349; Tefsiri “El Burhan”, vëll. 1, f. 289; Tefsiri “Ajjashij”, vëll. 1, f. 177; “Biharul Enuar”, vëll. 25, f. 223; “Ujun Akhbar Rida”, vëll. 1, f. 231 -229.

Taberi, ka vdekur në vitin 310 hixhri. Ne jemi bazuar në botimin, që është realizuar në Egjipt, që përbëhet nga 30 vëllime.

2- Eth Tha'lebij, “El Keshfu uel Bejanu an Tefsijril Kur’an”. Ai është Ebu Is’hak Ahmed ibn Ibrahim El Tha'lebij El Nisaburij, i cili ka vdekur në vitin 427 hixhri.

3- El Bagauij, “Mealimu et Tenzijl”. Ai është Ebu Muhamed El Husejn ibn Mes'ud bin Muhamed, i njohur si El Ferrau El Bagauij Esh Shafi’ij. Ka vdekur në vitin 516

hixhri. Jemi bazuar në botimin e Bejrutit, i cili përbëhet nga 4 vëllime.

4- Ez Zemehsherij, “El Keshshafu an Hakaiki Tenzilij ue Ujunil Ekauijli fi Vuxhuhi et Te'uijli”. Ai është Ebu Kasim Mahmud bin Umer ibn Muhamed bin Umer El Khauarizimi El Hanefij El Mu'tezelij, i mbiquajtur Xharullah. Ka vdekur në vitin 538 hixhri. Jemi bazuar në botimin e Egjiptit, të vitit 1948.

5- Err Rrazij, “Mefatihul Gajbi”. Ai është Ebu Abdullah Muhamed bin Umer ibn Husejn ibn Hasan ibn Ali Et Temijmij

El Bekrij Et Tabrestanij. Rraziu është mbiquajtur edhe Fakhrudijn, i njohur si ibn El Khatijb Esh Shafii. Ka vdekur në vitin 606 hixhri.

6- El Bejdauij, “Enuar Et Tenzijl ue Esraril Te'uijl”. Ai është gjykatësi i gjykatësve, Nasrudijn Ebu El Khajr, Abdullah bin Umer bin Muhamed bin Ali El Bejdauij Esh Shafii. Ka vdekur në vitin 691 hixhri. Jemi bazuar në botimin e Egjiptit, me dy vëllime, në vitin 1968.

7- El Kurtubij, “El Xhamiu lil Ahkamil Kur'an”. Ai është Ebu Abdullah Muhamed

ibn Ahmed ibn Ebi Bekr El Ensarij El Hazrexhij El Endelusij El Kurtubij. Ka vdekur në vitin 761 hixhri. Botimi i Egjiptit, 1950 dhe përbëhet nga 20 vëllime.

8- Ibn Kethijr, “El Kuran El Adhijm”. Ai është Hafidh Imadudijn Ebu El Fidai Ismail ibn Amru bin Kethijr bin Duui bin Kethijr ibn Zerau El Basrij Ed Dimeshkij. Ka vdekur në vitin 774 hixhri. Ky tefsir përbëhet nga pesë vëllime dhe është botuar në Bejrut.

9- Es Sujutij, “Durrul Menthur fi Et Tefsijri bil Me'thur”. Ai është Hafidh

Xhelaludijn Ebu El Fadl Abdurrahman bin Ebu Bekr bin Muhamed Es Sujutij. Ka vdekur në vitin 911 hixhri. Është botuar në Egjipt dhe përbëhet nga katër vëllime.

10- Al'lametu Shejh Ismail Hakki El Brusij, "Ruhul Bejan". Ka vdekur në vitin 1137 hixhri. Ky tefsir përbëhet nga tridhjetë vëllime. Ne i jemi përmbajtur botimit të Turqisë, të vitit 1330 hixhri.

11- El Al'lametu Ebu El Fadl Shehabudijn Es Sejid Muhamed El Alusij, "Ruhu El Meanij". Ka vdekur në vitin 1270 hixhri. Ai përbëhet nga tridhjetë vëllime.

Ne i jemi përmbajtur botimit të Egjiptit, të shtëpisë botuese “El Munirijetu”, 1945.

12- Al'lametu Esh Sham Muhamed ibn Xhemaludijn El Kasimij “El Kasimijul Musemma” (Mehasin Et Te'uijl). Ka vdekur në vitin 1322. Vepra përbëhet nga 17 vëllime. Ne jemi bazuar në botimin e shtëpisë botuese “Ihja Turathil Arabij”, Bejrut, 1415 hixhri.

Të gjithë këta tefsirë i kemi radhitur në bazë të vjetërsisë dhe rëndësisë së tyre.

Duke u nisur nga përgjegjësia e besimit dhe nga detyra e sheriatit, si dhe nga ekzistenca e disa boshllëqeve që duhet të mbushen me atë që është e domosdoshme dhe të përshtatet sipas

nevojës, si dhe duke iu përgjigjur urdhrit të Allahut të Madhëruar, i cili, në Kur'anin fisnik, na nxit herë pas here për dashurinë e familjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Thuaj: ‘Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen Time, vetëm se dashurinë për të afërmit.”**⁵, po e kryejmë këtë punë të begatë, për të nxjerrë në pah pozitën e lartë të familjes së pastër të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Për përgatitjen e këtij libri jemi bazuar te: “Tefsirul Emthel”, “Ehlul Bejt fi tefasijri Ehli Sunneh”, “Ajka e kuptimeve të

⁵ Sure “Esh-Shura”, ajeti 23.

Kur'ani Kerijmit", Hafiz Ibrahim Dalliu, si dhe te disa tefsirë, të cilët i kemi paraqitur në vazhdim.

Në përfundim, e falënderojmë Allahun e Madhëruar dhe i kërkojmë falje Atij për ndonjë mangësi apo gabim, sepse gabimet janë për robtë e Tij. Gjithashtu, falënderojmë bashkëpunëtorët tanë të mrekullueshëm, që ndihmuan në përgatitjen e kësaj vepre të çmuar. Allahu i ruajtë, i mbarësoftë dhe i begatoftë në të dy jetët!

Shoqata "Flladi"

**TEFSIRI I AJETIT TË MUBAHELESË
TE KOMENTUESIT E EH LI SUNETIT**

1- Tefsiri i ajetit të Mubahesë (lutja për mallkim) sipas Et Tabariut

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا وَأَبْنَاءَكُمْ وَ
نِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَل لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj të

**Iutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë
gënjeshtarët!"⁶**

* Ibn Hamidi ka transmetuar nga Xheriri, nga Mugijretu, se Amiri ka thënë: "Ai (i Dërguari i Allahut) u urdhërua që të mallkonte banorët e Nexhranit, me fjalën e Allahut të Madhëruar: **"Atyre që të kundërshtojnë ..."**

Ata i lanë takim të nesërmen dhe u zotuan që të mallkojnë. Shkuan te Sejidi dhe El Akibu, të cilët ishin më të zgjuarit e tyre dhe i pasuan ata të dy. Më pas shkuan

⁶ Sure "Âl Imran", ajeti 61.

te një burrë tjetër prej tyre, që ishte më i zgjuar se të gjithë dhe ia treguan se për çfarë kishin rënë dakord me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Çfarë keni bërë?! - i pyeti ata.

Më pas, u foli, deri sa i bëri të pendohen.

- Në qoftë se është Profet dhe ju thërret, atëherë dijeni se Allahu nuk e mërzit atë për ju, asnjëherë, ndërsa, në qoftë se është engjëll dhe del para jush, nuk ka për të lënë askënd prej jush, - u tha ai.

Ata i kërkuan se si t'ia bënin, pasi i kishin premtuar se do të takoheshin me të.

Kur zbardhi dita tjetër, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte marrë në krahë Hasanin dhe kishte kapur për dore Hysenin, ndërsa prapa tyre ecte Fatimja.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i thirri ata.

- Kërkojmë mbrojtje prej Allahut! – iu përgjigjën ata.

I thirri për herë të dytë dhe ata sërish i thanë disa herë: ‘Kërkojmë mbrojtje prej Allahut!’

- Pranojeni Islamin dhe do të përfitoni atë që përfitojnë myslimanët; do të keni atë

që kanë myslimanët, - u tha Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).⁷

* Ibn Hamidi ka transmetuar nga Isa ibn Ferkadi, atë që i kishte treguar Ebu El Xharudi, nga Zejd ibn Aliu, për Fjalën e Allahut të Madhëruar: **“Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj”**. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të*

⁷ Tefsiri “Et Taberi”, vëll. 3, f. 299, ajeti 61. E ka përzgjedhur El Hasekanij në “Shauahidu Et Tenzijl”, vëll. 1, f. 120, Botuar në Bejrut.

dhe mbi familjen e tij!) ishte me: Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysenin”.⁸

* Muhamed ibn Hyseni ka transmetuar nga Ahmed ibn El Mufadali, nga Es Suddiji, historinë e zbritjes së ajetit: **“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria”**. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e mori për dore Hasanin, Hysenin dhe Fatimen. I tha Aliut t’i ndiqte. Doli me ta. Atë ditë nuk doli askush prej të krishterëve. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

⁸ Tefsiri “Et Tabari”, vëll. 3, f. 300.

tij!) ka thënë: “Në qoftë se do të dilnin, do të digjeshin”.⁹

* Junusi e ka transmetuar historinë nga Ibn Uehebi, ashtu si e ka treguar Ibn Zejdi: “E pyetën të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se me kë do të vinte, në qoftë se do ta mallkonte atë popull, kur tha: **‘Bijtë tanë dhe bijtë tuaj’**. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u përgjigj: ‘Me Hasanin dhe Hysenin’.”¹⁰

⁹ Tefsiri “Et Tabari”, vëll. 3, f. 300.

¹⁰ Tefsiri “Et Tabari”, vëll. 3, f. 301.

* Muhamed ibn Sinani ka transmetuar nga Ebu Bekr El Hanefi, atë që i kishte treguar Mundhir bin Tha'lebetu, nga Ulbau ibn Ahmar El Jeshkrij: “Kur zbriti ajeti: **“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë gënjeshtarët!”**”, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lajmëroi Aliun, Fatimen dhe dy djemtë e tyre, Hasanin dhe Hysenin dhe thirri jehudët (çifutët) për mallkim.

Një djalosh çifut u tha: ‘Mjerë ju! A nuk morët shembull nga vëllezërit tuaj të mëparshëm, të cilët u kthyen në majmunë dhe derra? Mos dilni, të mallkoheni!’ Çifutët nuk dolën”.¹¹

* Hasan ibn Jahja ka transmetuar nga Abdurrezaku, nga Muameri, nga Kutade, historinë që rrodhi, për fjalën e Allahut të Madhëruar: **“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë**

¹¹ I njëjti burim.

gënjeshtarët!" Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), deshte të mallkonte banorët e Nexhranit, e mori për dore Hasanin dhe Hysenin dhe i tha Fatimes: "Na ndiq". Kur armiqtë e Allahut e panë këtë gjë, u kthyen".¹²

Nga ajeti i Mubahesë (lutjes për mallkim), përftohet:

1- Madhështia e atyre katër personave, me të cilët doli i Dërguari i

¹² Tefsiri "Et Tabari", vëll. 3, f. 301.

Allahut dhe pozitën e lartë që gëzojnë tek Allahu i Madhëruar.

2- I Dërguari i Allahut, me veprimin e tij, deshi t' u tregonte njerëzve se ata ishin të veçantët e tij, të dashurit dhe të afërmit e tij. Në mesin e tyre askush nuk është i barabartë me ta, sepse, nëse do të kishte të tillë, do të ishin pranë tij në këtë situatë të vështirë.

3- I Dërguari i Allahut, nëpërmjet kësaj ngjarjeje të njohur, bëri përpjekje të tregojë se kush është Ehli Bejti i tij. Këtë nuk e bëri vetëm për shoqërinë islame, por deshi t'ua tregojë edhe atyre që nuk janë myslimanë, sikurse ishin jehuditët dhe të krishterët.

2- Komentimi i ajetetit të Mubahesë (lutjes për mallkim), sipas tefsirit të Eth Tha'lebijit

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ وَ
نِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona, gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që

**mallkimi i Allahut t'i godasë
gënjeshtarët!"¹³**

* Eth Tha'lebiji ka thënë: "I Dërguari i Allahut ia lexoi këtë ajet delegacionit nga Nexhrani dhe i ftoi ata të dalin dhe të luten, që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët.

- Ne do të shkojmë sot dhe do ta diskutojmë midis nesh këtë çështje, - i thanë ata. - Nesër do të kthehemi te ti.

¹³ Sure "Âl Imran", ajeti 61.

Të nesërmen, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte marrë Hysenin në krahë, Hasanin për dore. Fatimja vinte pas tij dhe Aliu vinte pas saj.

- Unë i ftova dhe ata më besuan! - fliste duke ecur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- O bashkësia e krishterë! - iu drejtua një prift nga Nexhrani. - Unë po shoh fytyra që, nëse i kërkojnë Allahut të Lartësuar të lëvizë malet nga vendi, i lëviz ato. Mos dilni të mallkoheni, se do të shkatërroheni dhe nuk do të mbetet në

faqen e tokës asnjë i krishterë, deri në Ditën e Kiametit.

- O Ebu Kasim, ne e gjuquam, që të mos mallkohemi!- i thanë ata. - Ty të lëmë në fenë tënde dhe ne, të qëndrojmë në fenë tonë.

- Nëse nuk dëshironi të dilni, që të mallkohemi, atëherë pranoni Islamin dhe përfitoni atë që përfitojnë myslimanët dhe juve ju takon ajo që u takon atyre, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ata kundërshtuan.

- Unë ju ndaj prej arabëve, - iu drejtua i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Ne nuk kemi fuqi të përballojmë luftën e arabëve, - iu përgjigjën ata. - Ne dëshirojmë të bëjmë paqe me ty, që të mos na luftosh, të mos na frikësosh dhe të mos na kthesh nga feja jonë. Si shpërblim, do të paguajmë dy mijë barrë ushqime. Një mijë në muajin Safer dhe një mijë në muajin Rexheb.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëri paqe me ta.

- Pasha Atë, në të cilin është shpirti im! Dënimi i banorëve të Nexhranit zbriti, - tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). - Nëse ata do të kishin dalë, që të mallkoheshin, do të ishin kthyer në majmunë dhe derra dhe lugina do të mbushej me zjarr. Banorët e Nexhranit dhe çdo gjë tjetër, edhe zogjtë në pemë, do të shfaroseshin. Pa u plotësuar viti, do të zhdukeshin të gjithë të krishterët.¹⁴

¹⁴ Ahmed bin Hambeli e ka transmetuar në librin e tij "El Fadail", f. 27; El Uahidij e ka transmetuar në librin e tij "Esbabu Nuzul", f. 74; Et Taberani e ka transmetuar në librin e tij "Delailu En Nubuveti", vëll. 1, K. 21, f. 197.

3- Komentimi i ajetetit të Mubahesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit të El Bagauijit

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا وَأَبْنَاءَكُمْ وَ
نِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَ الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

Iutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"¹⁵

El Bagauiji, për ajetin: “**Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë**”, ka thënë: “Bijtë tanë janë Hasani dhe Hyseni. Në togfjalëshin “gratë tona” përfshihet Fatimja, ndërsa togfjalëshi “veten tonë”, nënkupton të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). (Enfusena ue Enfusekum) argumenton imamatin (udhëheqjen) e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!), si dhe

¹⁵ Sure “Âl Imran”, ajeti 61.

Allahu i Madhëruar e ka bërë pjesë të shpirtit të të Dërguarit të Allahut. Ai ka të njëjtat të drejta gjatë udhëheqjes së tij, përveç profetësisë”.

* I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia lexoi këtë ajet delegacionit të Nexhranit dhe i ftoi ata të dilnin. Ata thanë se para që të vendosnin, do të këshilloheshin me të afërmit e tyre dhe do t’ia jepnin të nesërmen përgjigjen. E diskutuan ndërmjet tyre. E pyetën të parin e tyre, që njihej si këshilltar.

- O Abdulmesijh, si mendon se duhet të veprojmë?

- O ju të krishterë, ju kam treguar se Muhamedi është Profet dhe i Dërguar! - iu drejtua atyre. - Pasha Allahun! Të gjithë popujt që janë mallkuar nga Profetët, kanë vdekur e s'ka mbetur asnjë prej të vegjëlve të tyre. Nëse do ta bëni këtë, s'ka për të mbetur askush prej jush e do të zhdukemi të gjithë. Po keni dëshirë të mbeteni në atë fe që jeni, jepini lamtumirën mikut tuaj dhe largohuni për në vendin tuaj.

Të nesërmen, shkuan tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai kishte në prehër Hysenin, e mori për dore Hasanin. Fatimja ecte pas tij, ndërsa Aliu ishte pas saj.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ecte dhe thoshte: 'Unë ju ftoj dhe ju besoni!'

- O ju të krishterë, unë po shoh fytyra, që po t'i luten Allahut të lëvizë malet nga vendi, do t'i lëvizi ato, - u tha një prift i krishterë nga Nexhrani. - Mos dilni të mallkoheni, sepse do të shkatërroheni dhe nuk do të mbetet në faqe të tokës asnjë i krishterë prej jush, deri në Ditën e Kiametit.

- O Ebu Kasim, ne vendosëm, që të mos mallkohemi dhe ty të të lëmë në fenë tënde dhe ne të qëndrojmë në fenë tonë, - i thanë ata thanë.

- Nëse nuk jeni dakord, që të mallkohemi, atëherë pranojeni Islamin dhe

keni të njëjtat të drejta si myslimanët, duke qenë të barabartë me ta, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ata nuk pranuan dhe e kundërshtuan fjalën e tij, atëherë i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ftoi në betejë.

- Ne nuk kemi fuqi të matemi dhe të përballemi në luftë me arabët, por dëshirojmë të lidhim marrëveshje paqeje me ty, me kusht që ti të mos na luftosh, as të mos na frikësosh dhe as të mos na

detyrosh të kthehemi nga feja jonë. Ne do t'ju japim dy mijë barrë çdo vit. Një mijë në muajin Safer dhe një mijë në muajin Rexheb, - iu përgjigjën ata.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pranoi marrëveshjen me këto kushte.

- Pasha Atë, që e ka shpirtin tim! Unë e pashë ndëshkimin e banorëve të Nexhranit, - iu drejtua i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). - Nëse ata do të ishin mallkuar, do të ktheheshin në majmunë dhe derra dhe do të piqeshit në luginën para tyre, që do të mbushej me zjarr. Allahu do t'i zhdukte banorët e Nexhranit

dhe gjithçka kishte në të, edhe zogjtë në pemë. Pa u mbushur viti, do të ishin shfarosur të gjithë të krishterët.¹⁶

¹⁶ Tefsiri “El Bagauj”, vëll. 1, f. 240; El Hamuejni ka transmetuar në librin “Faraidu Simtejn”, vëll. 2, K. 4, f. 23, Botimi i parë. Gjithashtu, e ka transmetuar Ibn El Megazilij, në librin “Menakibul Emijril Mu'minij”, Hadithi 310, f. 263; El Bagauj në librin “Mesabijhu's Suneti”, vëll. 2, f. 201, si dhe Ibn Haxheri, në “Es Saaikul Muhrika”, f. 93.

4- Komentimi i ajetetit të Mubahelesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit “El Keshaf”

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿قَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"¹⁷

* Zamakhsherij ka thënë: "I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia lexoi këtë ajet delegacionit të Nexhranit dhe i ftoi në lutje për mallkim.

- Të shkojmë dhe të këshillohemi me të afërmit tanë dhe do të kthehemi nesër, - i thanë ata.

E diskutuan ndërmjet tyre. E pyetën të parin e tyre, që njihej si këshilltar.

¹⁷ Sure "Âl Imran", ajeti 61.

- O Abdulmesijh, si duhet të veprojmë?

- O ju të krishterë, ju kam treguar se Muhamedi është Profet dhe i Dërguar, - iu drejtua ai. - Pasha Allahun! Të gjithë popujt që janë mallkuar nga Profetët, kanë vdekur, s'ka mbetur asnjë prej tyre. Nëse do ta bëni këtë, s'ka për të mbetur askush prej jush, do të zhdukemi të gjithë. Po keni dëshirë të mbeteni në fenë që jeni, jepini lamtumirën mikut tuaj dhe largohuni për në vendin tuaj.

Të nesërmen, erdhën tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai kishte në prehër

Hysenin. E mori për dore Hasanin. Fatimja ecte pas tij, ndërsa Aliu ishte pas saj.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ecte dhe thoshte: 'Unë ju ftoj dhe ju besoni!'

- O ju të krishterë, unë po shoh fytyra që, po t'i luten Allahut të lëvizë malet nga vendi, do t'i lëvizi ato, - u tha një prift i krishterë nga Nexhrani. - Mos dilni të mallkoheni, sepse do të shkatërroheni dhe nuk do të mbetet në faqe të tokës asnjë i krishterë prej jush, deri në Ditën e Kiametit.

- O Ebu Kasim, ne vendosëm të mos mallkohemi, - i thanë ata. - Ty të lëmë në fenë tënde dhe ne të qëndrojmë në fenë tonë.

- Nëse nuk jeni dakord të mallkohemi, atëherë pranojeni Islamin dhe keni të njëjtat të drejta si myslimanët, duke qenë të barabartë me ta, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ata nuk pranuan dhe e kundërshtuan, atëherë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ftoi në betejë.

- Ne nuk kemi fuqi të matemi në luftë me arabët, - iu përgjigjën ata, - por dëshirojmë të lidhim marrëveshje paqeje me ty, me kusht që ti as të mos na luftosh, as të mos na frikësosh dhe as të mos na detyrosh të kthehemi nga feja jonë. Ne do

t'ju japim dy mijë barrë çdo vit. Një mijë në muajin Sefer dhe një mijë në muajin Rexheb.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pranoi marrëveshjen me këto kushte.

- Pasha Atë, që e ka shpirtin tim! Unë e pashë ndëshkimin e banorëve të Nexhranit, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). - Nëse ata do të mallkoheshin, do të kthyeleshin në majmunë dhe derra dhe do të piqeshin në luginën para tyre, e cila do të mbushej me zjarr. Allahu do t'i zhdukte banorët e

Nexhranit dhe gjithçka kishte në të, edhe zogjtë në pemë. Pa u mbushur viti, do të ishin shfarosur të gjithë të krishterët.¹⁸

Zamakhsherij ka transmetuar nga Aishja se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) doli një ditë nga shtëpia dhe kishte veshur një pallto leshi të zezë. Në atë kohë erdhi Hasani dhe ai e mbështolli me të. Më pas erdhi Hyseni, Fatimja dhe Aliu. Të gjithë i mbështolli me të dhe tha: “O Familje e Profetit, në të vërtetë, Allahu do që t’jua

¹⁸ Tefsiri “El Kesh’shaf”, vëll. 1, f. 326, Botuar në Egjipt, viti 1948.

largojë papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht".¹⁹

Zamakhsherij bën edhe një pyetje: Ne themi se i Dërguari i Allahut i ftoi të bënin mallkimin, që të dilte në pah se kush ishte gënjeshtari dhe kush ishte i drejti. Kjo çështje i takon vetëm atij. Përse duhet të merrte me vete edhe fëmijët, edhe gratë?

Ky është një argument se ai ishte në të vërtetën dhe ishte i sigurt në sinqeritetin e tij. Ai ishte gati të përballte me rrezikun më të dashurit e shpirtit të tij. Nuk u mjaftua vetëm duke rrezikuar jetën e tij. Ai ishte i sigurt se kundërshtarët e tij ishin në

¹⁹ I njëjti burim.

humbje dhe me të dashurit e tyre do të shkatërroheshin, në rast se do të bëhej mallkimi.

Janë veçuar fëmijët dhe gratë, sepse janë njerëzit më të dashur të zemrës. Njerëzit japin jetën për ta dhe luftojnë me gjithë zemër për t'i mbrojtur ata. Ky ishte edhe shkaku që i merrnin me vete gjatë luftërave dhe betejave, që të luftonin me gjithë shpirt dhe të mos largoheshin nga fusha e betejës, por të jepnin edhe jetën në mbrojtje të tyre. Kjo është arsyeja pse ata janë përmendur.

Gjithashtu, është argument i qartë mbi Profetësinë e të Dërguarit të Allahut, i cili nuk i kundërshtoi, por doli me

familjarët e tij, duke iu përgjigjur thirrjes së tyre.²⁰

²⁰ I njëjti burim, f. 327.

5- Komentimi i ajetetit të Mubahesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit “El Kebijr” i Fakhrudijn Rraziut

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ
وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshтарët!"²¹

* Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua paraqiti argumentet të krishterëve të Nexhranit, por ata këmbëngulën në injorancën e tyre. Atëherë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: "Allahu më urdhëroi që, nëse nuk i pranoni argumentet, të bëj lutje për mallkim për ju".

- O babai i Kasimit, ne po kthehemi ta diskutojmë edhe një herë këtë çështje,

²¹ Sure "Âl Imran", ajeti 61.

pastaj do të vijmë me një vendim, - iu përgjigjën ata.

Shkuan dhe u konsultuan te një i urtë.

- O rob i Mesihut, si mendon? - e pyetën.

- O të krishterë! Pasha Allahun! - iu përgjigj ai. - Ju e dini se Muhamedi është Profet, i dërguar nga Allahu. Kur një Profet e mallkon një popull, nuk jeton prej tyre asnjë plak i vjetër dhe nuk lind në të asnjë fëmijë i vogël. Nëse do ta bëni një gjë të tillë, do të zhdukeni dhe do të shuheni.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte dalë dhe kishte veshur një rrobë

leshi të zezë. Kishte marrë në krahë Hysenin dhe për dore kishte Hasanin. Fatimja ecte pas tyre dhe në fund, vinte Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

- Unë i thirra dhe ata më besuan!, - ecte duke thënë i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- O bashkësia e krishterë, unë po shoh fytyra, që, po t'i kërkojnë Allahut të lëvizë prej vendit malin, Ai do t'u përgjigjet, duke e lëvizur atë. Mos u mallkoni, se do të shfaroseni dhe s'do të mbetet në faqen e tokës asnjë i krishterë, deri në Ditën e Kiametit, - u tha peshkopi i Nexhranit.

- O babai i Kasimit, ne vendosëm, që të mos bëjmë lutje për mallkim dhe të të lemë ty në fenë tënde, - thanë ata.

- Nëse nuk e pranuat lutjen për mallkim, atëherë pranojeni Islamin dhe do të keni të drejta të barabarta me myslimanët, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Edhe këtë mundësi, ata e kundërshtuan.

- Unë ju ftoj në luftë! - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Ne nuk fuqi të luftojmë kundër arabëve, - u përgjigjën ata, - por duam të bëjmë marrëveshje me ju, që të mos na luftoni dhe të qëndrojmë në fenë tonë. Si këmbim, ju japim juve çdo vit dy mijë shporta, një mijë në muajin Safer dhe një mijë në muajin Rexheb. Gjithashtu, ju japim 30 mburoja të zakonshme prej hekuri.

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e nënshkroi marrëveshjen me këto kushte.²²

²² Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 8, f. 80, ajeti 61. El Fakhr Err Rrazij ka shtuar komentin e tij mbi këtë tregim: “Duhet të dihet se dijetarët e hadithit dhe të tefsirit janë të një mendimi për vërtetësinë e këtij hadithi”.

* Fakhru Err Razii,j në tefsirin “El Kebijr”, vëll. 8, f. 8, Çështja e katërt, ka thënë: “Ky ajet tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Hasanin dhe Hysenin (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) i thërriste fëmijë dhe si të tillë, i thërresim edhe ne, si fëmijë të tij. Këtë e argumenton fjala e Allahut të Lartësuar, në suren “El En’am”, ajetet 84-88: **“Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët. Ne udhëzuam edhe Zekerijan, Jahjain, Isain, Iljazin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë. Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit. Ne**

zgjodhëm dhe udhëzuar në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre”.

Dihet se nëna e Isait u bashkëngjit si pasardhës i Ibrahimit.

6- Komentimi i ajetit të Mubahesës (lutjes për mallkim) sipas tefsirit El Bejdauij

Allahu i Madhëruar ka thënë:

﴿... فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“...Thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë gënjeshtarët!’”²³

²³ Sure “Al Imrân”, ajeti 61.

* Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua paraqiti argumentet të krishterëve të Nexhranit, por ata këmbëngulën në injorancën e tyre. Atëherë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “Allahu më urdhëroi që, nëse nuk i pranoni argumentet, të bëj lutje për mallkim për ju”.

- O babai i Kasimit, ne po kthehemi ta diskutojmë edhe një herë këtë çështje, pastaj do të vijmë me një vendim, - iu përgjigjën ata.

Shkuan dhe u konsultuan tek një i urtë.

- O rob i Mesihut, si mendon? - e pyetën.

- O të krishterë! Pasha Allahun! - iu përgjigj ai. - Ju e dini se Muhamedi është Profet, i dërguar nga Allahu. Kur një Profet e mallkon një popull, nuk jeton prej tyre asnjë plak i vjetër dhe nuk lind në të asnjë fëmijë i vogël. Nëse do ta bëni një gjë të tillë, do të zhdukeni dhe do të shuheni.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte dalë dhe kishte veshur një rrobë leshi të zezë. Kishte marrë në krahë Hysenin dhe për dore kishte Hasanin.

Fatimja ecte pas tyre dhe në fund, vinte Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ecte duke thënë: “Unë i thirra dhe ata më besuan.”

- O bashkësia e krishterë, unë po shoh fytyra, që, po t’i kërkojnë Allahut të lëvizë prej vendit malin, Ai do t’u përgjigjet, duke e lëvizur atë. Mos u mallkoni, se do të shfaroseni dhe s’do të mbetet në faqen e tokës asnjë i krishterë, deri në Ditën e Kiametit, - u tha peshkopi i Nexhranit.

- O babai i Kasimit, ne vendosëm, që të mos bëjmë lutje për mallkim dhe të të lemë ty në fenë tënde, - thanë ata.

- Nëse nuk e pranuat lutjen për mallkim, atëherë pranojeni Islamin dhe do të keni të drejta të barabarta me myslimanët, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Edhe këtë mundësi, ata e kundërshtuan.

- Unë ju ftoj në luftë! - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Ne nuk fuqi të luftojmë kundër arabëve, - u përgjigjën ata, - por duam të bëjmë marrëveshje me ju, që të mos na luftoni dhe të qëndrojmë në fenë tonë. Si këmbim, ju japim juve çdo vit dy mijë

shporta, një mijë në muajin Safer dhe një mijë në muajin Rexheb. Gjithashtu, ju japim 30 mburoja të zakonshme prej hekuri.

- Pasha Atë, që e ka shpirtin tim! Unë e pashë ndëshkimin e banorëve të Nexhranit, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). - Nëse ata do të mallkoheshin, do të ktheheshin në majmunë dhe derra dhe do të piqeshin në luginën para tyre, e cila do të mbushej me zjarr. Allahu do t'i zhdukte banorët e Nexhranit dhe gjithçka kishte në të, edhe zogjtë në pemë.

* Bejdauij, autori i tefsirit, ka thënë:
“Ky është argument për Profetësinë e të
Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut
qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për
mirësinë e atyre që erdhën nga Ehli Bejti i
tij”.²⁴

²⁴ Tefsiri “El Bejdauij”, vëll. 1, f. 164, Botimi i dytë,
Egjypt, 1968.

7- Komentimi i ajetit të Mubahesës (lutjes për mallkim) sipas tefsirit të El Kurtubiut

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿... فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“...Thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë gënjeshtarët!’”²⁵

²⁵ Sure “Al Imrân”, ajeti 61.

* Kurtubiu ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) erdhi me Hasanin dhe Hysenin. Fatimja ecte pas tij dhe Aliu ecte pas tyre.

- Unë i ftova dhe ata më besuan! - përsëriste i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kurtubiu, midis të tjerash, në lidhje për këtë çështje, ka thënë: “Shumë dijetarë kanë thënë se fjala “bijtë”, në ajetin: **“Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj”**, i adresohet Hasanit dhe Hysenit. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të*

dhe mbi familjen e tij!) thotë për Hasanin dhe Hysenin: ‘Këta djemtë e mi, janë zotërinj’.

Ai i konsideron Hasanin dhe Hysenin si djemtë e tij.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: ‘Çdo fis dhe prejardhje shkëputet në Ditën e Gjykimit, përveç fisit dhe prejardhjes sime’²⁶.

²⁶ Tefsiri “El Kurtubi”, vëll. 4, f. 104.

8- Komentimi i ajetit të Mubahesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit të Ibn Kethirit

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ
وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë gënjeshtarët!’”²⁷

²⁷ Sure “Al Imrân”, ajeti 61.

* Ibn Merdeuijeh ka transmetuar nga Sulejman ibn Ahmedi, nga Ahmed ibn Daud El Mekki, nga Bishr ibn Mehran, nga Muhamed ibn Dijnar, nga Daud ibn Ebu Hind, nga Esh Sha'bij, nga Xhabiri, i cili ka thënë: “Tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkoi El Akibu dhe El Tajibi dhe i ftoi të bënin lutje për mallkim. Ata të dy caktuan ta bënin lutjen për mallkim ditën tjetër në drekë.

Të nesërmen në drekë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori për dore Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysenin dhe shkuan

te vendtakimi. I thirri të dilnin, por ata nuk pranuan.

- Pasha Atë, që e ka shpirtin tim! Unë e pashë ndëshkimin e banorëve të Nexhranit! – tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). - Nëse ata do të ishin mallkuar, lugina para tyre që do të mbushej me zjarr.

Xhabiri ka thënë se për ta zbriti ajeti: **“Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj”**. Shprehja e ajetit: **“veten tonë dhe ju vetë”**, përfshin të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Ali ibn ebu Talibin.

Togfjalëshi: **“bjtë tanë”**, përfshin Hasanin dhe Hysenin.

Togfjalëshi: “**gratë tona**”, përfshin Fatimen.

Në këtë formë, El Hakimi e ka transmetuar në Mustredikun e tij, nga Ali ibn Isai, nga Ahmed ibn Muhamed El Ez’heri, nga Ali ibn Xhaferri, nga Ali ibn Haxheri, nga Ali ibn Mes’huri, nga Daud ibn Ebu Hindi. Hadithi është Sahih sipas kushtit të Muslimit”.²⁸

²⁸ Tefsiri “El Kur’anul Adhijm”, vëll. 1, f. 319.

9- Komentimi i ajetit të Mubahesës (lutjes për mallkim) sipas tefsirit të Sujutit

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ
وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

Iutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"²⁹

* El Hakimi ka transmetuar nga Ibn Murdeuijeh, nga Ebu Naimi në "Ed Delail", se Xhabiri ka thënë: "Te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) erdhën El Akibu dhe Es Sejidi dhe i ftoi në Islam.

- E pranuan Islamin, o Muhamed! - i thanë ata.

- Gënjet! - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi*

²⁹ Sure "Al Imrân", ajeti 61.

familjen e tij!). - Po të doni, unë ju tregoj shkakun që ju pengon ta pranoni Islamin.

- Na e trego.

- Dashuria për kryqin, pirja e alkoolit dhe ngrënia e mishit të dërrit.

Xhabiri ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ftoi ata të bënin lutje për mallkim. Ata e lanë takimin ditën tjetër.

Të nesërmen, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori për dore Hasanin dhe Hysenin. Pas tyre vinte Aliu dhe Fatimja. Të gjithë së bashku shkuan te vendtakimi.

I thirri ata të dilnin, por nuk pranuan dhe nuk dolën. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: ‘Pasha Atë, që më ka dërguar me të drejtë! Nëse ata do të ishin mallkuar, lugina para tyre do të mbushej me zjarr’.

Xhabiri argumenton se për ata zbriti ajeti: **“Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj...”** Sifjalia: “veten tonë dhe ju vetë”, përfshin të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Ali bin ebu Talibni; “bijtë tanë”, Hasanin dhe Hysenin; “gratë tona”, Fatimen”.³⁰

³⁰ Unë them: Kjo ngjarje është argument për shumë gjëra. Më e rëndësishmja e tyre është se pjesëtarët e

* El Hakimi ka transmetuar nga Xhabiri se tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) erdhi një delegacion nga banorët e Nexhranit dhe e pyetën se çfarë thotë feja e tij për Isain.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u përgjigj: “Është Shpirti i Zotit dhe Fjala e Tij, robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij”.

Ehli Bejtit janë krijesat më të mira nga të gjitha krijesat. Nëse do të kishte krijesa të tjera më të mira se ata, në radhët e këtij umeti, do t'i kishte treguar Profeti Muhamed. Ata janë burrat dhe gratë, të vegjlit dhe të mëdhenjtë më të mirë. Askush nuk është si ata.

Ata e ftuan të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të dilnin dhe të mallkoheshin, sepse Isai nuk ishte i tillë.

- A ju gëzon kjo gjë ju? - i pyeti i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Po, - u përgjigjën ata.

Në rregull, meqë ju dëshironi, - tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

I mblodhi fëmijët e tij, Hasanin dhe Hysenin dhe shkoi.

- Mos e mallkoni këtë njeri! – u tha udhëheqësi i banorëve të Nexhranit. - Beto hem në Allah, nëse do ta mallkoni, do të shkatërrohet një prej dy grupeve.

Ata erdhën tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- O babai i Kasimit, ne nuk dëshirojmë të na mallkosh!- iu lutën të Dërguarit të Allahut. - Ata që e kërkuan një gjë të tillë, ishin mendjelehtë. Ne duam të na falësh.

- Ju kam falur, - tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). - E pashë ndëshkimin që po i afrohej Nexhranit.

* Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Mundhiri, El Hakimi, El Bejhekiji kanë transmetuar, se Sa'd ibn Ebu Uekasi ka thënë: “Kur zbriti ky ajet: **“A tyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë gënjeshtarët!”**”, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ftoi Aliun, Fatimen dhe dy djemtë e tyre, Hasanin dhe Hysenin dhe tha: ‘O Zot, kjo është familja ime!’”

* Ibn Xheriri ka transmetuar nga Ulja ibn Ahmar El Jeshkurij, i cili ka thënë: “Kur zbriti ajeti: **“A tyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t’i godasë gënjeshtarët!’”**, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ftoi Aliun, Fatimen dhe dy djemtë e tyre, Hasanin dhe Hysenin dhe thirri jehudët, për t’u mallkuar.

Një i ri nga jehudët tha: “Mjerë ju! A nuk ishin vëllezërit tuaj të mëparshëm, që u kthyen në majmunë dhe derra?! Mos kërkoni mallkimin, por largohuni!”

* Bejhekiji ka transmetuar në “Ed Delail” nëpërmjet Selemetu ibn Abdu Jusha, nga babai i tij, nga gjyshi i tij, se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dërgoi letër banorëve të Nexhranit, para se të zbresë “Ta Sijn” (sure “En-Nahl”): “Me Emrin e Zotit të Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Unë ju ftoj në adhurimin e Allahut dhe të largoheni nga adhurimi i njerëzve. Ju ftoj në nënshtrimin ndaj Allahut dhe të largoheni nga nënshtrimi ndaj njerëzve. Nëse nuk pranoni, paguani xhizjen e, nëse nuk pranoni të paguani xhizjen, atëherë pritni luftë ndërmjet nesh. Selam”.

Kur peshkopi i tyre e lexoi letrën, u trondit shumë. Ai ia dërgoi letrën një burri

nga banorët e Nexhranit, i cili quhej Shurhajibil ibn Uidatu dhe e pyeti se cili ishte mendimi i tij.

Shurhajbili u përgjigj: “E dimë se Allahu i ka premtuar Profetit të tij, Ibrahimit dhe birit të tij, Ismailit mbi Profetësinë e pasardhësve të tij dhe ne e besojmë atë e ky njeri, mund të jetë ai. Unë nuk mund të jap asnjë mendim mbi Profetësinë. Nëse do të ishte ndonjë mendim rreth ndonjë çështjeje të dynjasë, do të isha përpjekur të të jepja një të tillë”.

Peshkopi ua dërgoi këtë letër, njëri pas tjetrit edhe shumë banorëve të Nexhranit, për të marrë mendimin e tyre. Të gjithë dhanë të njëjtën përgjigje, si ajo e

Shurhajtë. Ranë dakord, që të dërgonin një delegacion tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): Shurhajtë ibn Uedatu, Abdullah ibn Shurhajtë dhe Xhebar ibn Fejd.

Delegacioni shkoi tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). E pyetën dhe i pyeti për çështje të ndryshme, deri sa e pyetën se çfarë thotë Islami për Isain, të birin Merjemes.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u përgjigj: “Deri më sot nuk më ka zbritur asgjë për të. Qëndroni këtu deri nesër, që

t'ju tregoj se çfarë do të më zbritet për Isain, të birin e Merjemes”.

Më pas zbriti ajeti: “Shembulli i krijimit të Isait tek Allahu është si shembulli i krijimit të Ademit që e krijoj prej balte...!” deri te “mallkimi i Allahut të jetë mbi gënjeshtarët”.

Ata kundërshtuan, që të pranonin atë që u tregoi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe mëngjesin e të nesërmes vendosën të mallkoheshin. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori Hasanin dhe Hysenin. Pas tyre ecte Fatimja. Bashkë me ta, atë ditë, ishin disa gra.

- Si do të bëhet, sikur ky njeri të jetë vërtet Profet? – pyeti Shurhajibili shokët e tij. - Nëse ai na mallkon, nuk do të mbetet prej nesh, në faqen e dheut, asnjë thua e asnjë fije floku.

- Çfarë mendimi ke? – e pyetën shokët e tij.

- Unë mendoj, që të veprojmë me urtësi. Shoh një njeri që nuk flet asnjëherë kot.

- Vepro si ta shohësh më mirë.

Shurhajtbi e takoi të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Unë mendoj, që të mos mallkohemi, por të ofroj diçka më të mirë se mallkimi.

- Çfarë është ajo?, - i tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Mendohu sot në darkë dhe deri nesër në mëngjes. Çfarë do të gjykosh për ne, do ta pranojmë atë, vetëm të mos na mallkosh, - tha Shurhajtbi.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

pranoi prej tyre xhizjen, që ata të mos mallkohen.³¹

³¹ E ka përzgjedhur Hasekanij në “Shauahidu Et Tenzij”, vëll. 1, f. 120, Botuar në Bejrut. “Menakib” i Ibn Megazilit, Hadithi. 313; Ahmed ibn Hambeli, në librin “Fadail Sahabeti”, Hadithi. 27. K. “Fadail Hasan dhe Husejn (Paqja qoftë mbi ta!”.

10- Komentimi i ajetit të Mubahesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit “Ruhul Bejan”

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ
وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"³²

* Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua paraqiti argumentet të krishterëve të Nexhranit, por ata këmbëngulën në injorancën e tyre. Atëherë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: "Allahu më urdhëroi që, nëse nuk i pranoni argumentet, të bëj lutje për mallkim për ju".

- O babai i Kasimit, ne po kthehemi ta diskutojmë edhe një herë këtë çështje,

³² Sure "Al Imrân", ajeti 61.

pastaj do të vijmë me një vendim, - iu përgjigjën ata.

Shkuan dhe u konsultuan tek një i urtë.

- O rob i Mesihut, si mendon? - e pyetën.

- O të krishterë! Pasha Allahun! - iu përgjigj ai. - Ju e dini se Muhamedi është Profet, i dërguar nga Allahu. Kur një Profet e mallkon një popull, nuk jeton prej tyre asnjë plak i vjetër dhe nuk lind në të asnjë fëmijë i vogël. Nëse do ta bëni një gjë të tillë, do të zhdukeni dhe do të shuheni.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte dalë dhe kishte veshur një rrobë leshi të zezë. Kishte marrë në krahë Hysenin dhe për dore kishte Hasanin, kurse Fatimja ecte pas tyre. Në fund, pas tyre vinte Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ecte duke thënë: “Kur unë të lutem, ju thoni: “Amin!”

- O bashkësia e krishterë, unë po shoh fytyra, që po t’i kërkojnë Allahut të lëvizë prej vendit malin, Ai do t’u përgjigjet, duke e lëvizur atë. Mos u mallkoni, se do të shfaroseni dhe s’do të mbetet në faqen e

tokës asnjë i krishterë, deri në Ditën e Kiametit, - u tha peshkopi i Nexhranit.

- O babai i Kasimit, ne vendosëm, që të mos bëjmë lutje për mallkim dhe të të lemë ty në fenë tënde, - thanë ata.

- Nëse nuk e pranuat lutjen për mallkim, atëherë pranojeni Islamin dhe do të keni të drejta të barabarta me myslimanët, - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Edhe këtë mundësi, ata e kundërshtuan.

- Unë ju ftoj në luftë! - u tha i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Ne nuk fuqi të luftojmë kundër arabëve, - u përgjigjën ata, - por duam të bëjmë marrëveshje me ju, që të mos na luftoni dhe të qëndrojmë në fenë tonë...³³

³³ Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 3, f. 44.

11- Komentimi i ajetit të Mubahesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit “Ruhul Meanij”

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ آبَاءَنَا وَأَبْنَاكُمْ
وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

Iutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"³⁴

* Ibn Abasi ka transmetuar: “Një ditë, tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) erdhi një delegacion prej katërmbëdhjetë personash, nga paria e Nexhranit. Ndërmjet tyre ishte kryetari dhe nënkryetari.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ftoi të pranonin Islamin. Ata i thanë se e kanë pranuar Islamin.

³⁴ Sure “Al Imrân”, ajeti 61.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i pyeti se cili ishte Islami i tyre. Ata thanë se e kanë pranuar Islamin para tij.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “Keni gënjer, tri gjëra ju pengojnë të pranoni Islamin: adhurimi i kryqit, ngrënia e mishit të dërrit, si dhe pretendimi juaj se Allahu ka fëmijë”. Më pas zbriti ajeti: **“Shembulli i krijimit të Isait...”**

Kur ua lexoi këtë ajet, i thanë se nuk e njihnin këtë që po u tregonte. Pastaj zbriti ajeti: **“A tyre që të kundërshtojnë ty...”**

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u

tha: “Allahu i Madhëruar më ka urdhëruar, se, nëse nuk e pranoni këtë që po ju them, do t’ju mallkoj”.

- O babai i Kasimit! - iu përgjigjën ata.
- Do ta mendojmë edhe një herë këtë çështje dhe do të vendosim.

Diskutuan ndërmjet tyre.

- Pasha Zotin! - filloi fjalën e tij njeri prej zotërinjve. - Ju e dini fort mirë se ky njeri është Profet, i Dërguar. Nëse ai na mallkon, do të shfarosemi. Çdo Profet që ka mallkuar një popull, nuk ka mbetur asnjë plak dhe nuk ka lindur asnjë i vogël. Nëse nuk dëshironi ta pasoni dhe dëshironi të qëndroni në fenë tuaj, ndahuni me të dhe kthehuni në vendin tuaj.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte dalë dhe me të ishte Aliu, Hasani, Hyseni dhe Fatimja.

- Nëse unë ju ftoj në Islam, a do të pranoni? – i pyeti i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ata refuzuan të mallkohen, u pajtuan për xhizje.³⁵

* Xhabiri ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të*

³⁵ Tefsiri “Ruhul Meani”, vëll. 3, f. 166-167.

dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Pasha Atë, që më ka dërguar me të drejtë! Nëse ata do të kishin pranuar të mallkoheshin, lugina do të ishte mbushur me zjarr”.³⁶

* Transmetohet se peshkopi i Nexhranit, kur e kishte parë të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke ardhur së bashku me Aliun, Fatimen, Hasanin e Hysenin, u kishte thënë: “O ju të krishterë! Unë po shoh fytyra që, nëse i kërkojnë Allahut të lëvizë një mal nga vendi i tij, do ta lëvizë atë, prandaj mos u mallkoni, se do të shkatërroheni”.³⁷

³⁶ I njëjti burim.

³⁷ I njëjti burim.

Ky tregim është argumenti më i qartë i profetësisë së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nëse nuk do të ishte i tillë, nuk do të ishin ndalur nga mallkimi. Kjo tregon për mirësinë e të dashurve të Allahut dhe të familjes së të Dërguarit të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të cilën nuk duhet të dyshojë asnjë besimtar.³⁸

* Muslimi dhe Tirmidhiu kanë transmetuar nga Sa'd ibn ebu Uekasi se, kur zbriti ajeti: **“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë**

³⁸ I njëjti burim.

tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!”, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) mori Aliun, Fatimen dhe dy djemtë e tyre, Hasanin dhe Hysenin dhe tha: “O Zot, këta janë familja ime!”³⁹

* Ibn Ebu Il'lan ka transmetuar këtë tregim nga Muatezili, duke sjellë si argument se Hasani dhe Hyseni kanë qenë në moshë madhore, sepse mallkimi lejohet vetëm për ata që kanë hyrë në moshë madhore.

³⁹ I njëjti burim, f. 168.

Që të ndodhë kjo, nuk është e domosdoshme, që të jenë në moshë madhore, mjafton që të jenë të pjekur mendërisht. Hasani dhe Hyseni mund të mos kenë qenë në moshë madhore, por kjo nuk i pengoi që të kenë qenë të pjekur mendërisht. Edhe nëse thuhet se pjekuria e mendjes në atë moshë nuk është e mundur, sërish do të ishte e pranueshme për ta e jo për të tjerë, si argument i pozitës së tyre tek Allahu i Madhëruar dhe i cilësive të shumta që ata gëzojnë.⁴⁰

⁴⁰ Tefsiri “Ruhul Meani”, vëll. 3, f. 168.

12- Komentimi i ajetit të Mubahesë (lutjes për mallkim) sipas tefsirit “El Kasemij”

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا وَأَبْنَاءَكُمْ
وَأَنْسَاءَنَا وَأَنْسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: ‘Ejani t’i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të

lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"⁴¹

* El Hafidhu Ebu Bekr ibn Merdeuijeh ka transmetuar nga Esh Sha'biji, i cili ka transmetuar nga Xhabiri se tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) erdhi një delegacion. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ftoi të nesërmen në lutjen për mallkim.

Ditën tjetër, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori për dore Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysenin. Më pas e lajmëroi

⁴¹ Sure "Al Imrân", ajeti 61.

delegacionin, por ata nuk pranuan të mallkoheshin.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Pasha Allahun, që më ka dërguar me të drejtë! Nëse do të ishin mallkuar, lugina do të ishte mbushur me shi zjarri”.

Xhabiri ka thënë se kjo pjesë e ajetit: “**veten tonë dhe ju vetë**”, tregon të Dërguarin e Allahut dhe Ali ibn ebu Talibin; togfjalëshi “**bijtë tanë**”, tregon Hasanin dhe Hysenin; togfjalëshi “**gratë tona**”, i adresohet Fatimes.

* El Hakimi ka transmetuar në “Mustedrekun” e tij nga Shu’betu, nga Mugijretu, nga Esh Sha’biji, se kjo histori është më e sakta.⁴²

⁴² Tefsiri “El Kasimi”, i njohur si “Mehasinu Et Te’uijl”, vëll. 2, f. 71.

13- Ajeti i Mubahesë (lutjes për mallkim), sipas Hafiz Ibrahim Dalliut

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا وَأَبْنَاءَكُمْ وَ
نِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَلْ لَعْنَةَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ﴾.

“Kushdo që të polemizojë me ty rreth çështjes së Isait, pasi ty të erdhi dituria (pasi ty të zbritën argumentet dhe pasi ti ua tregove atyre), u thuaj (kundërshtarëve): ‘Ejani të thërresim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe veten tuaj (të mblidhemi në një vend) dhe pastaj t’i

lutemi Zotit që të lëshojë mallkimin mbi ata që gënjejnë”⁴³

Shpjegime

Ky ajet quhet “ajeti i Mubàhelesë”. Fjala “mubàhele” do të thotë: “lutem seriozisht për mallkimin e tjetrit”.

Kur Profeti Muhamed ua këndoi këtë ajet priftërinjve të Nexhranit, ata shikuan shoku-shokun, dolën jashtë xhamisë dhe i thanë kryetarit të tyre: “Ç’thua ti, a të bëjmë mubàhele me Muhamedin?” Kryetari që quhej Akil, u

⁴³ Sure “Al Imrân”, ajeti 61.

tha: “Për Zotin e vërtetë! Edhe ju e morët vesh se Muhamedi është profet i vërtetë dhe e kuptuat se fjalët e tij janë të drejta. Pra, në qoftë se do të bëni mubàhele me të, do të rrezikoheni, sepse të gjitha kombet që kanë bërë mubàhele me profetët e tyre, janë zhdukur. Prandaj sonte i kërkojmë leje për t’u menduar rreth kësaj pike, pastaj nesër i themi ç’kemi për t’i thënë”.

Priftërinjtë, hynë përsëri te Profeti Muhamed, i kërkuan leje që të mendoheshin mirë e mirë për atë punë. Ai u dha leje. Atë natë priftërinjtë u menduan dhe vendosën t’i thoshin Profetit Muhamed: “Ne nuk bëhemi myslimanë, por do të japim haraç dy mijë palë rroba të kuqe në vit dhe tridhjetë këmisha hekuri,

me kusht që të mos na hapësh luftë dhe ne të shkojmë e të rrimë në vendin tonë”.

Të nesërmen, Profeti Muhamed u bë gati për mubàhele, vuri në kokë taxhën e zezë, thirri pranë gratë e veta, bijën e tij, të madhen Fatime dhe djemtë e saj, Imam Hasanin e Imam Hysenin, thirri edhe Imam Aliun e Selman Farisiun. Priftërinjtë erdhën dhe i treguan vendimin e tyre. Profeti Muhamed e pranoi vendimin e tyre dhe lidhi paqe me ta.

Prej këtij ajeti, kuptohet se bijtë e vajzës janë si bijtë e vet. Profeti Muhamed, duke mos pasur djem, u detyrua t’u thoshte priftërinjve: “Të thërrasim djemtë

tanë” dhe thirri pranë vetes nipat e tij të nderuar, Imam Hasanin e Imam Hysenin.

Prej ajetit nënkuptohet se lejohet mallkimi i gënjeshtarëve, i mohuesve e keqbërësve, por pa caktuar ndonjërin me emër; p.sh, lejohet të thuhet “Mallkimi i Zotit qoftë mbi gënjeshtarët!” por, nëse përmendet ndonjë me emër, nuk lejohet, përveç atyre që dihet se kanë vdekur mohues.⁴⁴

⁴⁴ Marrë nga libri: “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Kerijmit”, f. 334.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Ne jemi krenarë që kemi Imamët tanë të Ehi Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), të cilët janë të pagabueshëm dhe të pastër, duke filluar nga Imam Ali ibn ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe duke e mbyllur me ndihmëtarin e njerëzimit, me Imam Mehdiun (*Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!*), udhëheqësin e kohës. Bekimet dhe përshëndetjet e panumërta qofshin mbi të! Ai, me dëshirën e Allahut të Gjithëpushtetshëm, është i gjallë, duke zgjidhur çështjet.

Ne jemi krenarë që edhe sot e kësaj dite, falë dijetarëve, teologëve, baballarëve dhe shehlerëve të nderuar, drita e Ehli

Bejtit është e pranishme në trojet tona shqiptare dhe kjo dritë na ndriçon zemrat, mendjet dhe gjithë qenien tonë, që të jemi të dashur me të tjerët, t'i duam dhe t'i respektojmë ata. Drita e Ehli Bejtit na ndriçon rrugën drejt Allahut të Madhëruar. Është detyrë e të gjithëve ne, që këtë dritë ta ruajmë dhe t'ua përcjellim brezave të ardhshëm.

Ai që do Ehli Bejtin, ai që ndjek rrugën e tyre dhe i merr shembull në jetën e përditshme, atij i pranohen punët, i pranohet pendimi dhe do të fitojë faljen e Allahut. Profeti Muhamed ka thënë: *“Ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes si dëshmor; ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes me mëkate të*

falura; ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes i penduar; ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes besimtar, me besim të plotësuar”.

Ai që e do Ehli Bejtin, ai që e ndjek rrugën e tyre dhe i merr shembull ata në jetën e përditshme, do të përgëzohet me Xhenet. Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “S’ka dyshim se ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, përgëzohet nga engjëlli i vdekjes me Xhenet e pastaj nga Munkeri e Nekiri. S’ka dyshim se ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, përcillet për në Xhenet, ashtu siç përcillet nusja te shtëpia e bashkëshortit të saj. S’ka dyshim se ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit,

i hapen te varri dy porta prej portave të Xhenetit. S'ka dyshim se ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, Allahu ia bën varrin vendprehje të engjëjve të mëshirës".

O Zoti ynë! Na bëj prej ndjekësve të dashur të Tu, në këtë jetë dhe na bashko me ata në Jetën Tjetër!

O Zoti ynë! Na dhuro shefeatin e Profetit Muhamed dhe të Ehli Bejtit në Jetën Tjetër!

المباهلة في الإسلام

اسم الكتاب: المباحلة في الإسلام

الإعداد: الشيخ ولت (عباس) مريا

الصحيح الادبي: بيريدا كولا

الصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعيت نسيم

تيرانا: 2023